



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 385/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit G. Zh , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.637/17 të dt.30.3.2017, për veprës penale :uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par 1 të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit G. Zh dhe të prokurorit të shtetit Ardita Beqiraj , me dt.24.5.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri G. Zh i lindur me dt.20.4.1954 në fsh.Q . K e P , , i biri i E dhe nënës M e gjinisë K , , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par 1 nën par 1.1. të KPPK-së

REFUZOHET AKTAKUZA

Gjëja se :

Që nga Janari i vitit 2017 e gjerë me sot , në Pejë në rrugën A. R , në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të të dëmtuarit L. A , e cila paluajtshmëri evidentohet me emrin e pasardhësit B. A , e cila paluajtshmeri evidentohet me numër 01-1030-17 ngastra katastrale me numër P -71611071 -00050-67 zona katastrale në Pejë në sipërfaqe prej 408 m³ , në atë mënyrë q i pandehuri që nga ajo kohë vazhdon ta shfrytëzon pronën e lartcekur dhe të njëjtën nuk e liron edhe për kundër faktit që këtu i dëmtuari ka biseduar me të pandehurin dhe ka kërkuar që t'ia liron , por ky i fundit një gjë të tillë nuk e pranon .

-me çka kishte për të kryer vepre penale : uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par 1 të KPRK-së.

-sepse prokurori i shtetit hoqi dorë nga ndjekja penale kundër të pandehurit .

Shpenzimet procedurale ju ngarkohen mjeteve buxhetore të gjykatës

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.30.3.2017 kundër të pandehurit G. Zh , ka ngritë aktakuzë PP/II nr.637/17 , për vepër penale : uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par 1 të KPRK-së duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- nuk e ka pranuar fajësinë dhe ka deklaruar se shtëpinë e kam lëshuar para një jave dhe që nga fillimi kam qenë i gatshëm që ta liroj siç kam deklaruar edhe në polici me dt. 14.3.2017.

Para fillimit të shqyrtimit fillestar i dëmtuarit L. A me dt. 24.5.2017 në deklaratë para gjykatës -sipas shënimit zyrtar ka deklaruar: Megjithatë sot me dt. 24.5.2017 në ora 13:30 unë kam qenë tek shtëpia të cilën ne e kemi blerë dhe në të cilën paraprakisht ka jetuar këtu i pandehuri G. Zh. dhe me këtë rast kamë vërejtur se shtëpia në fjalë ka qenë e liruar nga këtu i pandehuri G. dhe nga gjësendet e tija . Unë kam hyrë edhe brenda në shtëpi dhe vërejtja se G.i të njëjtën e kishte liruar

Pas kësaj prokurori ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar:

Duke u bazuar në deklarinimin e të pandehurit i cili që nga momenti i njoftimit nga ana me policisë është shprehur i gatshëm që ta liroj pronën sapo të bëjë zgjidhje për banim ku një gjë të tillë edhe e ka bërë ku kemi marrë edhe konfirmimin e të dëmtuarit L. A i cili i ka bërë të ditur gjykatës që objekti i ti – shtëpia i është liruar nga ana e të pandehurit për afërsisht para një jave dhe tash e tutje e ka në posedim të lirë , andaj konform nenit 52 të KPPRK-së heqë dorë nga ndjekja penale kundër të pandehurit G.Zh dhe tërheqë aktakuzën me numër P /II nr. 637/17 të dt. 30.3.2017

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 363 par 1 pika 1.1. të KPPRK u vendos si në dispozitivin e aktgjykimit, përkatësisht kundër të pandehurit është refuzuar aktakuza .

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 25.5.2017.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi palët me të drejtë ankese
Mund të paraqesin ankesë në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .